

**EKSPozITA KOMBËTARE
E KULTURËS MATERIALE
POPULLORE SHQIPTARE**

**THE NATIONAL EXHIBITION
OF THE MATERIAL CULTURE
OF THE ALBANIAN PEOPLE**





**EKSPOZITA KOMBËTARE
E KULTURËS MATERIALE
POPULLORE SHQIPTARE**

**THE NATIONAL EXHIBITION
OF THE MATERIAL CULTURE
OF THE ALBANIAN PEOPLE**



«...Të luftohet më me këmbëngulje për të studiuar karakteristika kombëtare në drejtime të ndryshme të kulturës dhe të arteve tona dhe për zbatimin e tyre në mënyrë krijuese në veprat e sotme të artit dhe në punën kulturore-artistike me masat».

ENVER HOXHA

«...More persistent efforts must be made to study the national characteristics in the various aspects of our culture and arts and to apply them in a creative manner in today's works of art and in the cultural-artistic work with the masses.»

ENVER HOXHA

SHTËPIA BOTUËSE «8 NËNTORI» TIRANË 1982

THE «8 NËNTORI» PUBLISHING HOUSE TIRANA 1982





Pamje e ekspozitës në rrugën
«Enver Hoxha», Shkodër.

View of the exhibition in «Enver Hoxha»
Street, Shkodra



Ceremonia e çeljes së Ekspozitës Kombëtare të Kulturës
Materiale Popullore Shqiptare.

From the opening ceremony of the National Exhibition
of the Material Culture of the Albanian People




H

istoria e popullit tonë është histori luftërash të përgjakshme për liri e pavarësi kombëtare, për zhvillim, dritë dhe përparim shoqëror. Pjesë e gjallë dhe e pandarë e kësaj historie dhe shprehje e vitalitetit të popullit tonë është edhe kultura e tij e pasur dhe e lashtë materiale e shpirtërore.

«Në këto troje të lashta të të parëve tanë, — ka thënë shoku Enver Hoxha, — kanë vërshuar grekët, romakët, normandët, sllavët, anzhuinët, bizantët, venedikasit, osmanë e shumë e shumë pushtues të tjerë, por ata nuk i zhdukën dot as popullin shqiptar, as kulturën e vjetër ilire, as vazhdimësinë e saj shqiptare».

Në veprat që ruhen sot në Shqipëri, në epokën e madhe të socializmit, shkëlqen gjenia krijuese e popullit tonë, talenti dhe mjeshtëria e këtij artisti të madh.

Revolucioni popullor e ka vlerësuar dhe ngritur lart pasurinë e pafund të kulturës e të artit tonë popullor. Me kujdesin e madh të PPSH dhe të shokut Enver Hoxha traditat e artit dhe të zejtarisë sonë popullore kanë marrë një zhvillim të mëtejshëm me prodhimin e sotëm të objekteve artistike dhe të konsumit të gjerë nga kombinatet e tekstitit, të trikotazhit, nga ndërmarrjet artistike, nga fabrikat e qelqit, porcelanit, plastikës dhe nga fshati ynë socialist. Kudo spikatin dashuria dhe kujdesi për krijmtarinë e gjithanshme popullore. E bukura e selitur me mendim të thellë e ndjenjë të hollë, me origjinalitet kombëtar në Shqipërinë tonë të re socialiste u përcillet brezave.

Në kuadrin e 40-vjetorit të themelimit të PPSH dhe të Kongresit të 8-të të saj, në kooperativa bujqësore, në ndërmarrje, shkolla etj. u ngritën 275 ekspozita të kulturës popullore, me mbi 31.000 objekte. Përveç këtyre rreth 16.000 objekte përfaqësuese, të gjinive dhe të llojeve të ndryshme, të artit dhe të zejtarisë popullore të prodhuara në të kaluarën dhe sot, u paraqitën në 26 ekspozitat e hapura në rrethet e vendit.

Rruga «Enver Hoxha» në Shkodër, qytet me tradita të lashta kulturore, më 24 tetor 1981, me hapjen këtu të Ekspozitës Kombëtare të Kulturës Materiale Popullore, që është një muze i vërtetë dhe mjaft i pasur i kulturës materiale të popullit tonë, mori pamjen e një ansambli kulturor me vlera të çmueshme.

Objektet më përfaqësuese që janë vendosur në stendat e kësaj ekspozite nxjerrin në pah vlerat e çmueshme të artit dhe të zejtarisë sonë popullore. Ato janë dëshmi e rëndësisë së madhe që kanë ruajta, studimi dhe propagandimi i kulturës materiale popullore, zhvillimi më tej dhe zbatimi i motiveve dhe i karakteristikave origjinale kombëtare në prodhimin e sotëm.

**EKSPOZITA KOMBËTARE E KULTURËS
MATERIALE POPULLORE SHQIPTARE**



Th

e history of our people is a history of bloody wars for freedom and national independence, for development, knowledge and social progress. An inseparable part of this history, a vivid expression of the vitality of our people, is their rich and ancient material and spiritual culture.

«The Greeks, the Romans, the Normans, the Slavs, the Anjous, Byzantines, the Venetians, the Ottomans and many many other invaders have hurled themselves upon these ancient territories of our forefathers,» says Comrade Enver Hoxha «but they did not succeed in wiping out either the Albanian people, or their ancient Illyrian culture and its Albanian continuation.»

The creative genius of our people, the great artistic talent and skill shines brilliantly in the works preserved to this day in Albania, in the great epoch of socialism.

The people's revolution has evaluated and raised high the endless wealth of our people's culture and art. Thanks to the great care of the PLA and Comrade Enver Hoxha, the traditions of our people's art and crafts have assumed a further development with today's ornamental goods for use on a mass scale, produced by the textile mills, the knit-wear factories, the artistic products enterprises, the glass, porcelain and plastics factories and our socialist villages. Love and care for every aspect of the people's creativeness stand out everywhere. In our new socialist Albania, the beautiful, expressing profound thought and fine sentiments with national originality, is handed on from generation to generation.

In the framework of the 40 anniversary of the founding of the PLA and its 8th Congress, 275 exhibitions of the people's culture, with more than 31.000 objects, were opened in agricultural cooperatives, enterprises, schools, etc. Besides these, about 16.000 samples of various genres of folk art and crafts produced in the past and today, were displayed in the 26 exhibitions opened in the districts of the country.

When the National Exhibition of the Material Culture of the Albanian People, which is a real museum with a rich display of the material culture of our people, was opened there on October 24, 1981, «Enver Hoxha» Street in Shkodra, a city with ancient cultural traditions, assumed the appearance of a cultural ensemble of priceless values.

The most representative objects displayed in this exhibition highlight the priceless values of our folk arts and crafts. They are testimony to how very important it is to preserve, study and propagate the material culture of the people, to further develop and apply the original national motifs and characteristics in present-day production.

THE NATIONAL EXHIBITION OF THE MATERIAL CULTURE OF THE ALBANIAN PEOPLE



Mbi 800 mjeshtra popullorë, artistë dhe specialistë të ndërmarrjeve e të kooperativave bujqësore, janë marrë me prodhimin e objekteve artistike të përdorimit të përditshëm, të mbështetur në stilet dhe teknikat e zbatuara tradicionalisht nga populli ynë krijues. Reparte të reja për punime të holla në dru ulliri, apo guacka deti janë ngritur në Krujë, Vlorë e Sarandë, për ambalazhimin artistik të shisheve në Shijak, për prodhimin e veglave muzikore në Pukë etj.

Gurit të vendit tonë malor, simbol i qëndresës dhe i fortësisë, aleat lufte dhe jete, populli ynë me fantazinë e vet të pasur i ka dhënë forma nga më të ndryshmet për të zbukuruar jetën, e ka bërë atë «të flasë».

Mjeshtra popullorë nga të gjitha viset e Shqipërisë, gurkalitës me famë të Dibrës e të Gjirokastrës, të Skraparit e të Beratit, të Përmetit e të zonës së Himarës, të Gorës e të Mokrës etj. kanë derdhur në gur botën e tyre të pasur, të shprehur me motive nga epika dhe lirika e jetës së popullit tonë, që nga shqiponjat e lulet deri te dreri e ylli.

Themelet e qyteteve të lashta ilire, kështjellat e shumta, urat e bukura, shtëpitë karakteristike, kalldrëmet, çezmat, vatrat e oxhaqet apo tavanet janë dëshmi e syrit të mprehtë dhe dorës së shkathët e të sigurtë të popullit tonë artist.



More than 800 folk craftsmen, artists and specialists of various enterprises and agricultural cooperatives were engaged on the production of artistic objects of daily use, based on the styles and technique traditionally used by our creative people. New workshops have been set up for fine work in olive wood or sea shells at Kruja, Vlorë and Saranda, for ornamental bottles at Shijak, the production of musical instruments at Puka, etc.

Our people with their rich phantasy, have taken the stone of our mountainous country, the symbol of resistance and strength, their ally in war and in life, and have given it the most varied forms to beautify it and have made it «speak».

Folk craftsmen from all regions of Albania, famous stone-carvers from Dibra and Gjirokastra, Skrapar and Berat, Përmet and the Himara zone, Gora and Makra, etc., have poured into stone their spiritual wealth expressed in motifs from the epic and lyric of the life of our people, ranging from eagles and flowers to the deer and the star.

The foundations of ancient Illyrian cities, the numerous castles, the beautiful bridges, characteristic houses, cobble-stone streets, the fountains, the fire-places, or the ceilings of rooms, are all proof of the keen eye and the sure and skilful hand of our artist people.

Objektet arkeologjike të zbuluara tregojnë për një kulturë e traditë të lashtë të popullit tonë edhe në punimet e qeramikës. Mjeshtëria dhe teknika origjinale e disa qendrave të njohura si e Farkës në Tiranë, e Gojanit në Pukë, e Bradvicës në Korçë, e Kavajës etj. ruhen e zbatohen në prodhimet e sotme të qeramikës.



Pamje nga ekspozita e Tiranës.

View of the Tirana Exhibition

The archaeological objects discovered tell of an ancient culture and traditions of our people in ceramic works, too. The original craftsmanship and technique of several renowned centres such as that of Farka in Tirana, Gojan in Puka, Bradvica in Korça, Kavaja, etc. are preserved and applied in the present-day ceramic products.


Dëshmi që flasin për tradita të vjetra e zhvillim të hershëm për kulturë të veten origjinale dhe qytetërim të të parëve tanë janë edhe punimet e ndryshme në metal. Të dëgjura kanë qenë qendrat e punimit të metaleve me ngjyra në filigran si Shkodra, Prizreni e Gjakova.

Elbasani dhe Tirana janë shquar për teknikën e rrahjes dhe të derdhjes së metaleve me ngjyrë, ndërsa Berati për teknikën e savatit. Nga gjiri i popullit tonë kanë dalë jo vetëm luftëtarë të shquar por edhe mjeshttra të talentuar armësh.



The various works in metal, also, are testimony to the ancient tradition and early development of the original culture and civilization of our forefathers. Shkodra, Prizren and Gjakova were famous as centres for filigree work in non-ferrous metals.

Elbasan and Tirana were outstanding for the technique of swaging and casting of non-ferrous metals, while Berat for the technique of enchasing. Not only outstanding fighters but also talented armourers have emerged from the ranks of our people.



Në kudhrën e kovaçit hekuri ka marrë formën e ushtës e të shpatës, të plorit e të parmendës. Ai është përdorur në kangjellat e shtëpive, në fenerët karakteristike e në objekte të shumëllojta zbukurimi e të përdorimit shtëpiak, tradita këto që janë ruajtur e zbatohen edhe në ditët tona.

Mjeshtri popullor e ka gdhendur drurin me art të hollë. Talenti e durimi i tij prej artisti janë mishëruar në tavanet e rozetat, në trapazanet, në dyert e dritaret gjer edhe në sendet më të imta të vatrës familjare.

Në një nivel të lartë e ngritën artin e punimit të drurit mjeshtërit e Dibrës e të Beratit, mjeshtërit shqiptarë të Rekës e të Konicës etj. Mbi traditën e këtyre punohet kudo sot druri në vendin tonë.

Arti i hollë spikat edhe në punimet prej materialesh të thjeshta si thupra, gjineshtra, lëpushka, kashtë-xunkthi, kocka, briji etj.



Në ndërmarrjen artistike «Migjeni» në Tiranë


In the «Migjeni» Artistic Products
Enterprise in Tirana

On the blacksmith's anvil the iron has taken the shape of the lance, the sword, or the ploughshare. It has been used for wrought-iron work for houses; for the characteristic lamps and many kinds of house-hold decorations these traditions have been preserved to this day.

The folk craftsman has carved timber with superb artistry. His talent and patience as an artist have been embodied in the ceilings and rosettes, in the screens, doors and windows, down to the most minute objects of domestic use.


The craftsmen of Dibra and Berat, the Albanian master craftsmen of Reka, Konica, and elsewhere, raised the art of wood carving to a high level. Today wood-carving everywhere in our country follows their traditions.

The works in simple materials such as osier, broom, rushes, straw, reeds, bone, horn etc., also show fine artistry.



Muzeu
i
Gjergj
Kastriotit
(Skënder-
beu)
në
Krujë.

The
Museum
of
Gjergj
Kastrioti -
Scanderbeg
in
Kruja



Punime të
gurit e të qeramikës.

Stone carvings
and ceramic products





Në fabrikën e porcelanit në Tiranë.

In the Porcelain Factory in Tirana

Çdo krahinë e pothuaj çdo fshat i vendit tonë ka punimet e tij karakteristike në tekstil. Tekstilet e leshta, të prodhuara me teknika të shumëllojta, paraqiten mjaft të pasura në motive, harmoni, kompozimi dhe ngjyra. Mjeshtri popullor ka derdhur gjithë talentin e tij në to. Gjithçka shqiptari e ka dashur të bukur, të hijshme: veshjen, qilimin, hejbet etj.

Qilimat e sixhadet e Lumës e të Hasit, velenxat e Kurveleshit, Korçës, Dibrës e të Malësisë së Tiranës janë të përmendura në tërë vendin për bukurinë e tyre.

Gruaja shqiptare ka endur në pëlhura motive të qeta, shumë tërheqëse, duke zbatuar një teknikë të thjeshtë me dy dhe katër lisa. Kudo në Shqipëri, por, sidomos në Dumre, Fushë-Krujë e Myzeqe dyshekët e jastekët janë punuar me motive të gjalla e ngjyra të forta, po kështu edhe mbulesat e djeprit e përparëset e grave.

Pëlhurat e mëndafsha janë përdorur në të gjithë vendin. Tradita të pasura në punimin e këtyre pëlhurave kanë Shkodra, Tirana, Berati, Elbasani etj. Në trevën e Zadrimës (rrethi i Shkodrës) me fije mëndafshi prodhohen pëlhura fare të holla të tejdukshme.

Veshjet e shumëllojta nga krahinat e ndryshme të vendit zënë një vend të gjerë në stendat e kësaj ekspozite. Ato janë të larmishme, me zbulime e plot fantazi në jelekët e xhamadanët, në kanacet e pështjellakët, në këmbishët e mëngoret.

Këto veshje janë njëkohësisht edhe një dëshmi e unitetit etnohistorik të popullit tonë.

Traditat në punimin e tekstileve e të qëndisjeve me motive popullore pasqyrohen në prodhimet e sotme të kombinave të tekstileve, të fabrikave të trikotazhit e të ndërmarrjeve artistike.

Every region and almost every village in our country has its own characteristic textile work. The woollen textiles, produced by many different techniques, are rich in motifs, harmonious composition and colours. The folk craftsman has poured all his talent into them. The Albanian wanted everything beautiful and tasteful – his clothing, carpet, saddle bags, etc.

The rugs and carpets of Luma and Has, the blankets of Kurvelesh, Korça, Dibra and the Highlands of Tirana, are well-known throughout the country for their beauty.




The Albanian woman has woven very attractive and quiet motifs in cloths, employing a simple technique with two and four warps. The women's aprons everywhere in Albania, but especially in Dumre, Fushë-Krujë, and Myzeqe, and the mattresses, pillows and cradle covers, have been worked in vivid motifs with strong colours.

Silk fabrics have been widely used in Albania. Shkodra, Tirana, Berat, Elbasan etc., have rich traditions in producing them. In the Zadrima region, of Shkodra district, very fine, transparent silk fabrics are made.

The many different kinds of costume from the different regions of the country make up a considerable part of the display in this exhibition. They show a wide range of imaginative ornamentation on the vests and waistcoats, the belts and aprons, the shirt blouses and short jackets.

At the same time these costumes are evidence of the ethno-historical unity of our people.



The traditions in the working of textile and embroidery with folk motifs are reflected in the current products of the textile combines, knit-wear factories and artistic products enterprises.



Punime prej hekuri.
- Mjeshtra të punimit të hekurit, në Tiranë.

Iron work
- Skilled iron workers in Tirana





Punime të gdhëndura në dru.
Wood work



Arti dhe zejtaria jonë popullore me fizionominë e tyre kombëtare shqiptare, zënë një vend të merituar edhe në thesarin e kulturës botërore. Ato kanë tërhequr vazhdimisht vëmendjen edhe të studiuesve e të vizitorëve të huaj nga vende të ndryshme të botës.

Një grup turistësh francezë janë shprehur kështu:

«E madhe është habia jonë duke mbërritur në këtë qytet të vogël, ku gjetëm këtë ekspozim të shkëlqyer të artizanatit. Ne admirojmë të gjithë prodhimet, fryt i mundit të popullit, që janë përjetësuar në Shqipërinë e re».

«Të shohësh traditat e hulumtimeve të personalitetit të Shqipërisë është inkurajuese për popujt».

Njohja, studimi dhe propagandimi i vlerave të kulturës popullore po frymëzojnë dhe nxitin talentet e reja në fushën e artit popullor, mjeshtrat e apasionuar të fshatit e të qytetit, për të vënë në jetë porosinë e Partisë dhe të shokut Enver Hoxha që të ruhet si sytë e ballit thesari i kombit dhe të zhvillohet më tej ai. Vënia në jetë e kësaj porosie po ndihmon që prodhimet e reja artistike dhe të artizanatit të kenë përherë e më shumë fizionomi e ngjyrë kombëtare, të ruajnë dhe të zhvillojnë karakteristikat dalluese të artit tonë popullor, t'u përgjigjen kërkesave të reja të jetës socialiste të vendit tonë.

Our folk arts and crafts, with their Albanian national features, occupy a worthy place in the treasury of world culture. They have always attracted the attention of foreign scholars and visitors from various countries of the world.

This is what a group of French tourists said:

«Great was our astonishment when we arrived in this small town, to find this splendid exhibition of artistic handicrafts. We admire all the products, fruit of the toil of the people, which have been perpetuated in new Albania.»

«It is encouraging for the peoples to see the traditions of investigations of the individuality of Albania.»


The recognition, study and propagation of the values of the people's culture are inspiring and encouraging new talents in the field of folk art, the enthusiastic master craftsmen of town and countryside, to put into practice the instruction of the Party and Comrade Enver Hoxha that the wealth of the nation must be guarded like the apple of our eye and developed further. The practical application of this instruction is helping to ensure that the new artistic and handicrafts products have more and more a national appearance and colour, that they retain and develop the distinctive features of our folk art, and respond to the new demands of socialist life in our country.



Qendisja, e punime në pëlhurë.


Embroidery and needle work





Vizitorë të huaj në ekspozitën e Krujës.


Foreign visitors at the Kruja Exhibition





Punime briri, kocke dhe kashte.


Horn, bone and straw work





Punime argiendi në filigramë.

Silver filigree work



- Përgatiti/Prepared:
NAZIF SENJA – HARILLAO KEKEZI
- Fotografitë/Photos by:
JANI XIBINAKU
- Formulimi grafik/Graphic formulation:
FRANÇESK ZIRI

16

Shtypur në KOMBINATIN POLIGRAFIK

«Shtypshkronja e re», Tiranë, 1982.

Printed in the Polygraphic Combine

«Shtypshkronja e Re» Tirana 1982

16

EKSPOZITA KOMBËTARE E KULTURËS MATERIALE POPULLORE SHQIPTARE



THE NATIONAL EXHIBITION OF THE MATERIAL CULTURE OF THE ALBANIAN PEOPLE